



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KRYETARI

Nr. 4767 prot.

Tiranë, më 2 / 8 /2026

Lënda: Mbi zbatimin e vendimit nr. 15, datë 17.02.2026 të Gjykatës Kushtetuese, vendimit nr. 435, datë 26.08.2026 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe zhbllokimin e pagesave të gjyqtarëve

DREJTUAR: z. Petrit Malaj
Ministër i Financave
PËR DIJENI: z. Toni Gogu
Ministër i Drejtësisë
z. Ilir Rusi
Kryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor

TIRANË

I nderuar z. Ministër,

Sot, më 2 shtator 2026, Gjykata e Lartë është informuar në mënyrë verbale se në sistemin e thesarit, janë bllokuar pagesat e gjyqtarëve të Republikës, përfshirë edhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, për shkak të kundërshtive të autoriteteve financiare lidhur me mënyrën e zbatimit të vendimit nr. 15, datë 17.02.2026 të Gjykatës Kushtetuese. Sipas informacionit të komunikuar, kundërshtitë lidhen me mungesën e një ligji të ri të Kuvendit dhe me faktin se efektet financiare të rillogaritjes së pagës nuk janë planifikuar paraprakisht në buxhet.

Përpara dërgimit të kësaj shkrese, çështja është diskutuar me të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë dhe është marrë opinioni i tyre. Për rrjedhojë, vlerësimet dhe kërkesat e parashtruara më poshtë pasqyrojnë qëndrimin institucional të Gjykatës së Lartë, të formuar pas këtij konsultimi.

Duke qenë se kjo situatë prek drejtpërdrejt fuqinë detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, garancinë e paprekshmërisë së pagës së gjyqtarit sipas nenit 138 të Kushtetutës dhe marrëdhëniet ndërmjet pushteteve, vlerësojmë të nevojshme t'ju parashtrojmë më poshtë bazën juridiko-kushtetuese mbi të cilën është mbështetur vendimi nr. 435, datë 26.08.2026 i Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe aktet zbatuese të nxjerra nga organet kompetente të sistemit gjyqësor, përfshirë urdhrin përkatës të Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

1. Vendimi nr. 15/2026 dhe cenimi i nenit 138 të Kushtetutës

Gjykata Kushtetuese nuk e trajtoi çështjen si një kërkesë për rritje fakultative page, por si cenim të një garancie kushtetuese të statusit të gjyqtarit. Ajo konstatoi se ngrirja e pagës së magjistratëve, në kushtet kur pagat referuese dhe treguesit ekonomikë kishin pësuar rritje të konsiderueshme, përbënte një ulje të fshehtë dhe të shënjestruar.

“mosndryshimi i pagës së gjyqtarit përbën ulje të fshehtë të shënjestruar, që bie ndesh me nenin 138 të Kushtetutës.” (vendimi nr. 15/2026, par. 101)

“ligjvënësi ka detyrimin për të përshtatur pagën me zhvillimin e kushteve të përgjithshme ekonomike të vendit, në një periudhë kohore të caktuar dhe në raport edhe me zhvillimin e pagave të referencës ashtu edhe të funksionarëve të tjerë publikë.” (vendimi nr. 15/2026, par. 102)

“paga e tyre nuk është një shumë fikse parash e shënuar në ligjin për buxhetin e shtetit, por del nga një formulë që kishte dhe duhet të ketë për referencë një kategori page që i përshtatet zhvillimit ekonomik të vendit dhe ndryshon në kohë.” (vendimi nr. 15/2026, par. 104)

Ky konstatim ka rëndësi të drejtpërdrejtë edhe për argumentin e mungesës së planifikimit buxhetor. Vetë Gjykata Kushtetuese ka sqaruar se paga e magjistratit nuk është një shumë fikse që buron nga ligji vjetor i buxhetit. Buxheti është instrumenti financiar për realizimin e detyrimit. Ai nuk është burimi kushtetues i së drejtës dhe as kusht për ekzistencën e saj.

2. Detyrimi i Kuvendit dhe afati përfundimtar 31 korrik 2026

Gjykata Kushtetuese i njohu Kuvendit hapësirë normuese për të zgjedhur mënyrën e rregullimit, por jo të drejtën për të mos vepruar.

“i takon Kuvendit të miratojë ndryshimet ligjore të nevojshme, sipas arsytimit të këtij vendimi, që të shmangë uljen e fshehur dhe ta përshtasë pagën e magjistratëve në raport të drejtë me rritjet e tjera dhe detyrën e funksionin, gjë e cila duhet të realizohet brenda datës 31.07.2026.” (vendimi nr. 15/2026, par. 109)

“Kuvendi mund të zgjedhë të përshtasë formulën e re [...] duke iu referuar ndryshimit që pësoi kategoria e nëpunësve civilë në të cilët referonte formula e vjetër ose ndryshimit që pësoi paga e Presidentit, ose çdo zgjidhjeje tjetër të krahasueshme [...]” (vendimi nr. 15/2026, par. 109)

Diskrecioni i Kuvendit ishte, pra, hapësirë vlerësimi për gjetjen e zgjidhjes kushtetutshmërisht të përshtatshme, jo diskrecion për zbatimin ose moszbatimin e vendimit. Kjo përforcohet nga dispozitivi:

“Detyrimin e Kuvendit të miratojë ndryshimet ligjore të nevojshme, sipas arsytimit të këtij vendimi, brenda datës 31.07.2026.” (dispozitivi, pika 3)

“Efektet e shfuqizimit sa më lart hyjnë në fuqi ditën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore dhe, në çdo rast, jo më vonë se data 31.07.2026.” (dispozitivi, pika 4)

Shprehja “në çdo rast” e përjashton mundësinë që mosmiratimi i ligjit të shtynte efektet e shfuqizimit përtej datës 31 korrik 2026. Pas kësaj date formula e shfuqizuar nuk mund të vazhonte të përdorej.

3. Pasoja e mosveprimit të Kuvendit dhe formula e zbatueshme nga data 1 gusht 2026

Vendimi nr. 15/2026 nuk la një boshllëk pa zgjidhje. Në paragrafin 110 Gjykata Kushtetuese parashikoi shprehimisht pasojën e mosmiratimit të ligjit brenda afatit:

“nëse nuk bëhen ndryshimet ligjore deri në datën 31.07.2026, llogaritja e pagesave të prapambetura do të bëhet me formulën që i referohet funksionarit të administratës së lartë publike, sipas referencës së analizuar në vendimin nr. 35/2022 të kësaj Gjykate.” (vendimi nr. 15/2026, par. 110)

Pika e nisjes është pika 4 e dispozitivit, sipas të cilit efektet e shfuqizimit hyjnë në fuqi, “në çdo rast, jo më vonë se data 31.07.2026”. Për rrjedhojë, nga data 1 gusht 2026 dispozita që e lidhte pagën referuese bazë me koeficientin 0,36 të pagës së Presidentit nuk mund të prodhonte më efekte juridike. Mosmiratimi i ligjit të ri nga Kuvendi nuk mund të zgjaste jetën e një norme të shfuqizuar dhe as të neutralizonte afatin përfundimtar të vendosur nga Gjykata Kushtetuese.

Në këtë moment shtrohej domosdoshmërisht pyetja: *me çfarë formule duhej të përlllogaritej paga e magjistratëve nga 1 gushti 2026?* Përgjigjia nuk mund të ishte as vazhdimi i formulës 0,36, e cila kishte humbur efektet, dhe as mungesa e çdo formule. Neni 138 i Kushtetutës e garanton pagën si element të statusit dhe pavarësisë së gjyqtarit. Mosveprimi i ligjvënësit nuk mund ta bëjë këtë garanci të pazbatueshme në praktikë.

Pikërisht për këtë arsye paragrafi 110 duhet lexuar së bashku me paragrafin 109 dhe pikën 4 të dispozitivit. Megjithatë ai i referohet tekstualisht “pagesave të prapambetura”, për rastin e mosveprimit të Kuvendit deri më 31.07.2026 vetë Gjykata Kushtetuese identifikon formulën që i referohet funksionarit të administratës së lartë publike, sipas vendimit nr. 35/2022. Një interpretim sipas të cilit kjo referencë do të zbatohet për detyrimet deri më 31 korrik, por paga do të mbetet pa referencë nga dita pasuese, do ta bënte të paefektshëm si shfuqizimin e normës, ashtu edhe garancinë e nenit 138.

Ky lexim përputhet edhe me standardin e përgjithshëm të vendimit. Në paragrafin 104 Gjykata thekson se paga e magjistratit del nga një formulë që “kishte dhe duhet të ketë për referencë një kategori page që i përshtatet zhvillimit ekonomik të vendit dhe ndryshon në kohë”, ndërsa në paragrafin 108 kërkon që referenca të jetë një pagë që rritet dhe indekskohet në kohë.

Për rrjedhojë, nga 1 gushti 2026, deri në ndërhyrjen e ligjvënësit, referenca e funksionarit të administratës së lartë publike sipas standardit të vendimit nr. 35/2022 përbënte referencën kushtetutshme të zbatueshme. Kjo nuk nënkupton “ringjalljen” formale të dispozitës së

mëparshme, por zbatimin e drejtpërdrejtë të vendimit nr. 15/2026 në një situatë që vetë Gjykata Kushtetuese e kishte parashikuar. Ky përfundim përcakton standardin juridik që organet kompetente të sistemit gjyqësor duhej të zbatonin pas datës 31 korrik 2026.

4. Fuqia detyruese e vendimit të Gjykatës Kushtetuese

Sipas nenit 132 të Kushtetutës, vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim. Detyrueshmëria nuk kufizohet vetëm te dispozitivi. Gjykata Kushtetuese ka sqaruar se:

“Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit.” (vendimi nr. 55, datë 10.07.2024, par. 43)

Për gjykatat detyrimi është edhe më i drejtpërdrejtë. Neni 145, pika 2, i Kushtetutës përcakton se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për të gjitha gjykatat. Po kështu, neni 142, pika 3, parashikon detyrimin e organeve të shtetit për të ekzekutuar vendimet gjyqësore.

Detyrimi i ekzekutivit për zbatimin konkretizohet shprehimisht edhe në nenin 81, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar: “Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për zbatim” dhe “Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese sigurohet nga Këshilli i Ministrave me anën e organeve përkatëse të administratës shtetërore”. Në këtë kuadër, administrimi i thesarit duhet t’i shërbejë ekzekutimit të vendimit kushtetues dhe nuk mund të përdoret si instrument për pezullimin e efekteve të tij.

Fuqia përfundimtare dhe detyruese e vendimit të Gjykatës Kushtetuese do të thotë se as Kuvendi, as Këshilli i Ministrave, Ministria e Financave apo çdo organ tjetër shtetëror nuk mund të rihapë, rivlerësojë ose relativizojë atë që Gjykata Kushtetuese ka vendosur përfundimisht. Kuvendi mund të ushtrojë vetëm hapësirën normuese që vetë vendimi i ka njohur, ndërsa organet e ekzekutivit mund të përcaktojnë mekanizmat e nevojshëm për ekzekutimin e tij; asnjëri prej tyre nuk mund ta kushtëzojë zbatimin me pajtimin e vet me arsyetimin ose pasojat e vendimit. Vënia në diskutim ose pezullimi administrativ i efekteve të një vendimi të tillë do të cenonte drejtpërdrejtë nenin 132 të Kushtetutës, autoritetin e Gjykatës Kushtetuese dhe parimin e shtetit të së drejtës.

Për rrjedhojë, mosveprimi i Kuvendit nuk mund të shndërrohet në të drejtën e një organi të ekzekutivit për të pezulluar efektet e një vendimi të Gjykatës Kushtetuese. Një përfundim i kundërt do ta bënte fuqinë detyruese të vendimit kushtetues të varur nga vullneti i organit që duhet ta zbatojë.

5. Zbatimi institucional i detyrimit kushtetues nga organet e sistemit gjyqësor - jo caktim autonom i pagës

Në këtë çështje duhet bërë një dallim i qartë ndërmjet burimit juridik të së drejtës për pagën dhe akteve që vetëm e zbatojnë atë. Pagat e magjistratëve nuk janë caktuar nga KLGG-ja, nga Kryetari i Gjykatës së Lartë apo nga kryetarët në detyrë të gjykatave. Burimi juridik i trajtimit financiar është

Kushtetuta, veçanërisht neni 138, ligji për statusin e magistratëve dhe standardet detyruese të përcaktuara nga Gjykata Kushtetuese në vendimet nr. 35/2022 dhe nr. 15/2026.

Vendimi nr. 435/2026 i KLGJ-së nuk ka krijuar një politikë të re page dhe nuk ka zëvendësuar Kuvendin në ushtrimin e kompetencës ligjvënëse. Pas datës 31 korrik 2026, KLGJ-ja nuk kishte diskrecion as për të vendosur nëse do ta zbatonte vendimin kushtetues, as për të përcaktuar sipas vullnetit të saj një nivel të ri page. Ajo ka konkretizuar dhe unifikuar zbatimin e detyrimit kushtetues, duke marrë si referencë kategorinë e lartë drejtuese, Kategoria I, Klasa I-2, sipas VKM-së nr. 325/2023, të ndryshuar. Për rrjedhojë, vendimi nr. 435/2026 ka natyrë zbatuese dhe konkretizuese; ai nuk është akt vetëpërcaktimi i pagës.

Në zbatim të kësaj reference, për periudhën nga 1 gushti 2026 e në vazhdim, paga referuese bazë rezulton nga paga për pozicion prej 222.425 lekësh dhe shtesa e nivelit të kualifikimit “Grupi i diplomës I” prej 14.000 lekësh, në total 236.425 lekë.

Të njëjtën natyrë zbatuese kanë edhe urdhri i Kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe aktet përkatëse të kryetarëve në detyrë të gjykatave, të nxjerra në kuadër të administrimit financiar të gjykatave. Këto akte nuk përcaktojnë në mënyrë autonome një pagë të re, por urdhërojnë strukturat përkatëse financiare të zbatojnë vendimin nr. 15/2026 të Gjykatës Kushtetuese dhe vendimin nr. 435/2026 të KLGJ-së, brenda kompetencave të secilit organ.

Edhe nëse KLGJ-ja nuk do të kishte miratuar vendimin nr. 435/2026, nga data 1 gusht 2026 nuk mund të vijonte ligjërisht zbatimi i formulës së shfuqizuar. Detyrimi për t’i dhënë efekt vendimit nr. 15/2026 buronte drejtpërdrejt nga Kushtetuta dhe nga vetë vendimi i Gjykatës Kushtetuese. Aktet e organeve të sistemit gjyqësor nuk e kanë krijuar këtë detyrim; ato vetëm e kanë konkretizuar dhe bërë të njëtrajtshëm zbatimin e tij.

6. Mungesa e planifikimit buxhetor nuk pezullon detyrimin

Mungesa e një fondi të mjaftueshëm të planifikuar mund të kërkojë rishpërndarje, shtesë fondi, rishikim buxheti ose përdorimin e mekanizmave të tjerë të parashikuar nga legjislacioni financiar. Ajo nuk mund të transformojë një detyrim kushtetues në një detyrim fakultativ.

Vetë vendimi nr. 435/2026 i KLGJ-së ka parashikuar që, në rast nevojë për fonde shtesë në shpenzimet e personelit, të kërkohet pranë Ministrisë së Financave alokimi i tyre sipas legjislacionit buxhetor. Për diferencat e periudhës 1 prill 2023-31 korrik 2026, KLGJ-ja ka parashikuar përllogaritjen dhe ndjekjen e procedurave për sigurimin e fondeve përkatëse.

Kështu, mungesa e fondit është një çështje e ekzekutimit financiar të detyrimit dhe jo një bazë juridike për mohimin ose pezullimin e tij.

7. Bllokimi i të gjitha pagave të gjyqtarëve

Edhe nëse do të ekzistonte një mosmarrëveshje ndërinstitutionale mbi mënyrën e përllogaritjes së efekteve financiare të vendimit nr. 15/2026 të Gjykatës Kushtetuese, kjo nuk mund të justifikojë bllokimin e pagesave të gjyqtarëve.

Gjithashtu kjo mosmarrëveshje nuk nënkupton dhe as nuk mund të perligj vijimin e llogaritjes së pagës së gjyqtarëve pas datës 1 gusht 2026 sipas formulës së shfuqizuar. Siç u arsyetua më sipër, kjo formulë ka humbur efektet juridike jo më vonë se data 31 korrik 2026. Mosmarrëveshja mbi mënyrën e zbatimit të vendimit kushtetues duhet të trajtohet me mjetet juridike dhe institucionale përkatëse dhe nuk mund të shërbejë si bazë për pezullimin administrativ të trajtimit financiar të gjyqtarëve.

Bllokimi i pagesave, në këto rrethana, prek drejtpërdrejt garancinë e nenit 138 të Kushtetutës dhe, për rrjedhojë, edhe pavarësinë institucionale të pushtetit gjyqësor.

8. Kërkesa

Në këto rrethana, duke mbajtur parasysh fuqinë përfundimtare dhe detyruese të vendimit nr. 15/2026 të Gjykatës Kushtetuese, si dhe vendimin nr. 435/2026 të KLGJ-së, kërkojmë që Ministria e Financave të marrë pa vonesë masat e nevojshme për:

- zhbllokimin e menjëhershëm të pagesave mujore të gjyqtarëve;
- ekzekutimin, nga 1 gushti 2026 e në vijim, të pagës referuese bazë të përlogaritur në zbatim të vendimit nr. 15/2026 të Gjykatës Kushtetuese dhe vendimit nr. 435/2026 të KLGJ-së;
- ndjekjen e procedurave buxhetore për alokimin e çdo fondi shtesë që rezulton i nevojshëm për pagesat korrente;
- trajtimin e diferencave financiare për periudhën 1 prill 2023-31 korrik 2026 sipas përcaktimeve të vendimit nr. 435/2026, pa i përdorur ato si shkak për bllokimin e pagave korrente.

Vlerësojmë, në përputhje me qëndrimin e formuar pas konsultimit me të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, se një zgjidhje e menjëhershme institucionale është e domosdoshme jo vetëm për të shmangur pasojat individuale për gjyqtarët, por mbi të gjitha për të garantuar respektimin e autoritetit të Gjykatës Kushtetuese dhe të parimit të ndarjes e balancimit të pushteteve.

Në një shtet të së drejtës, mosveprimi i një organi kushtetues nuk mund të shndërrohet në të drejtën e një organi tjetër për të mos zbatuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Përkundrazi, pikërisht kur ligjvënësi nuk e ka përmbushur detyrimin brenda afatit të caktuar, respektimi i vendimit kushtetues bëhet thelbësor për ruajtjen e rendit kushtetues. Respektimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese nuk është çështje vullneti institucional, por detyrim kushtetues për çdo organ të Republikës.

Me respekt,

KRYETARI I GJYKATËS SË LARTË
SOKOL SADUSHI

